



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E -II- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË  
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 SHKURT 2019**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

*Lutfi Bilalli dhe Sami Istrefi, anëtarë të kuvendit që janë dorëhequr nga pozita e anëtarit të kuvendit, por procedura e zëvendësimit të këtyre pozitave nga ana e KQZ-së akoma nuk ka përfunduar.*

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, shumicë kjo e mjaftueshme për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - duke diskutuar jashtë rendit të ditës, paraqiti vërejtjet e tij adresuar strukturave komunale për siç tha mosrespektimin e Rregullores për përdorimin e automjeteve zyrtare të komunës, e aprovuar nga kuvendit i komunës. Tutje në referim të nenit 2 të kësaj rregulloreje ceku se në mënyrë taksative përcaktohet se automjetet zyrtare mund të përdoren vetëm nga kryetari i komunës, për më shumë për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që në mënyrë permanente bën monitorimin e zbatimit të kësaj rregulloreje. Në fund kërkoi nga drejtoria kompetente që ta zbatojë me përpikëri rregulloren në fjalë, ndërsa

nëse shtrohet nevoja për përdorimin tjetërfare të automjeteve zyrtare, atëherë duhet të iniciohet ndryshimi i kësaj rregulloreje.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** - nga kryesuesi i kuvendit dhe nga sekretaria kërkoi që të bëhen përpjekje që anëtarëve të Kuvendit komunal t'u mundësohet votimi elektronik i secilit propozim-vendim, në mënyrë që për çfarëdo vendimi që merret në këtë Kuvend të dihet se kush dhe si ka votuar. Pra, bëhet fjalë për pajisjet elektronike që e mundësojnë votimin me kartela identifikuese. Pra, votimi i anëtarëve të Kuvendit të regjistrohesh dhe të mbetet në arkivin e dokumenteve që dalin nga këtu. Në formën aktuale të votimeve, për secilin propozim po konstatohet vetëm shumica e thjeshtë, apo shumica e nevojshme, por nuk po dihet edhe identiteti i këshilltarit se si ka votuar. Mendoj që votimi elektronik i bën asamblistët më të përgjegjshëm para vetes dhe para qytetarëve, para se të përcaktohen për votimin PËR, KUNDËR, apo ABSTENIM, të secilit propozim-vendim. Nuk e di sa mund ta ketë koston një gjë e tillë, po ashtu nuk e di sa ka komuna kapacitete buxhetore për këtë, mirëpo e konsideroj si tepër të rëndësishme. Pastaj tha se, duhet ta cekim që po bëhen mbi 1 vit që kur po presim për kartela identifikuese të këshilltarëve komunal, por që ende nuk na janë bërë. Kohëve të fundit në rrjetin social facebook, nga një profil me emrin "Shpresa Kajtazi", që sipas të gjitha gjasave është një profil i rrejshëm, po rrjedhin vendime dhe informata zyrtare qoftë nga zyra e kryetarit, qoftë nga disa drejtori të tjera të komunës sonë, akoma pa u bërë publike dhe akoma pa i pa ne si këshilltarë komunal, apo si qeverisje komunale. Kush po i jep këto dokumente zyrtare tek këta individë, që për më keq, fshihen prapa profileve të rrejshme? Si po rrjedhin këto informata në publik? Dhe Cili mund të jetë qëllimi? Ndoshta, këto dokumente që i kam pa tek ky profil mund të mos jenë shumë të rëndësishme, por shtrohet pyetja <çka nëse del në publik ndonjë dokument që mund të konsiderohet si "sekret" i komunës e që nuk mund të ketë çdokush qasje në to>. Konsideroj që ky veprim duhet të trajtohet me seriozitetin e duhur, e nuk e di a ka bazë ligjore që edhe të fillojë nga ana e organeve të policisë.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - njoftoi se instalimi i votimit elektronik, bartë me vete një kosto financiare për të cilin duhet mendohet që të ndahen mjetet, ndërsa lidhur me kartelat identifikuese, për anëtarët e kuvendit njoftoi se ato janë të gatshme.

**Melihate Basholli - Latifi, anëtare e kuvendit** - kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që në fondi për ndërtim dhe rregullim të trotuareve të futet në planifikim vazhdimi i trotuarit në rrugën e vjetër në fshatin Bukosh, gjegjësisht prej shkollës të fshatit Bukosh në drejtim të rrugës së fshatit Duboc, konkretisht deri tek lagjja "Sadiku". Në arsyetimin e këtij projekti shtoi se kjo rrugë tani është shumë e frekuentuar për të kaluar në rrugën që dërgon për Skënderaj dhe fati tjetër me rëndësi është se në këtë rrugë shpesh ka pasur aksidente me lëndime trupore, por edhe me fatalitet ku një nxënës ka humbur jetën. Ndërsa çështja tjetër të cilën ajo e shtroi për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, është pyetja se përse nuk po vazhdohet projekti për përfundimin e kanalizimit në fshatin Bukosh, pasi ky projekt është votuar në kuvend, andaj ky projekt kur do të fillojë dhe kur është afati i përfundimit.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që në kuadër të pikës 6 të rendit të ditës të inkorporohet edhe nënpika 1.2 e vendimit Nr.01.22/19, gjegjësisht çështja që ka të bëjë me parcelën kadastrale P-70202016-02356-1 me sipërfaqe prej 1058 m<sup>2</sup>, pronë kjo për të cilën kuvendi ka vendosur që ta japë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, me qëllim të ndërtimit të lartë. Lidhur me këtë ai vlerësoi se kjo pikë e vendimit duhet të shfuqizohet pasi që komuna nuk ka kurrfarë interesi që në këtë formë të jap këtë pronë në shfrytëzim, dhe për këtë ai vlerësoi se duhet të gjenden mekanizma dhe forma adekuate të dhënies së kësaj prone në shfrytëzim ku do të ruhej interesi qytetar dhe ai i komunës.

**Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit** - kërkoi që t'i ofrohet ndihmë financiare një studenteje nga Vushtrria e cila është përzgjedhur në Akademinë e Animacionit në Francë. Bëhet fjalë për Ujeza Ademin nga fshati Pestovë, e njëjta është përzgjedhur në mesin e 500 aplikantëve në rajon dhe shuma financiare për akomodim që i nevojitet është 3.000 €.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar lëvizjeve të demonstratave të vitit 1981, demonstrata këto që tashmë kanë hyrë në histori, dhe ku ndër të tjera në këto demonstrata me datë 3 prill ishin vrarë: Sali Zeka, Ruzhdi Hyseni, Naser Hajrizi dhe Sali Abazi, andaj për këta të rënë të cilët duhet herët apo vonë të shpallen dëshmorë të kombit, duhet të kemi një vlerësim dhe konsideratë të veçantë në përkujdesjen shtetërore për ta dhe familjet e tyre. Andaj si konkluzion i krejt kësaj çështjeje kërkoi nga komuna të ketë një përkujdesje të veçantë për këto figura që me datë 3 prill të vendos kurora me lule në varret e këtyre dëshmorëve, si dhe të formohet një grup i organizuar që të bëjë edhe homazhe dhe vizitë tek familjet e këtyre të rënëve për liri.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** - tha se qeveria aktuale e komunës nuk është se ka sjellë ndonjë ndryshim, edhe përkundër proklamimit për transformim të qytetit ashtu siç ishte deklaruar kreu aktual i komunës. Në të kundërtën e kësaj kjo qeverisje e keqe përbrenda karakterizohet nga mashtrues dhe mashtrime të njëpasnjëshme që bëhen ndaj qytetarëve të komunës. Tutje vlerësoi se kreu i komunës është një njeri i apasionuar pas ekranit televiziv ku nuk dihet se a e përfaqëson komunën apo është ministër shteti, në këtë formë ai e ka humbur tërësisht lidhjen dhe është shpëputur tërësisht nga qytetarët e komunës. Andaj si rrjedhojë e krejt kësaj, sot shërbimet publike ndaj qytetarëve janë në nivelin më të dobët të mundshëm, duke filluar që nga sinjalistika rrugore, vijat nëpër rrugë, e shumë gjëra tjera e bëjnë Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që të ketë performancën më të dobët. Gjithashtu është e padrejtë që një anëtar i partisë që i përket drejtori aktual i kësaj drejtorie i Lëvizjes Vetëvendosje t'i dërgohen dhjetë drita për një shtëpi, kurse fshatra të tëra janë në terr. Pastaj pyeti kryetarin e komunës: se çfarë i duhet drejtorit të arsimit vetura 24 h, çfarë i duhet drejtorit të urbanizmit vetura 24h , apo kjo ka të bëjë vetëm me rritjen e luksit dhe shfrytëzimin e pushtetit për ta shkelur ligjin dhe për ta futur komunën në një anarki totale. Në fund ai u bëri lutje drejtorëve përkatës që në përgjegjësi morale mos të pranojnë vendimin për shfrytëzimin e këtyre veturave. Gjithashtu ai pandehi se kryetari i komunës është kryetar pa vizon dhe kështu ai ka vjedhur edhe sloganin qeverisës nga kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, "Për Shqipërinë dhe Bashkinë që Duam" në "Për "Vushtrrinë që Duam".

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë, të nderuar të pranishëm. Në mbledhjen e fundit të Kuvendit komunal, pikërisht më, 31 janar 2019, ky kuvend me vota unanime ka votuar: Propozim-vendimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për tri prona komunale. Është për t'u habitur se si kryetari i komunës e sjell në këtë mbledhje rishqyrtimin e të njëjtit vendim ende pa hyrë në fuqi. Po te konsiderohej si vendim që bie në kundërshtim me ligjet në fuqi, atëherë do të ishte në rregull të silllej në kuvend për rishqyrtim. Prandaj propozimi im është <të shtyhet për seancën e radhës, pika e 6 e rendit të ditës>, dhe arsyetim për pikën 1.1 dhe 1.3 të paragrafit 1, për sa i përket afatit të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, konsiderojmë se afati 99 vjeçar do të sillte investitorë më serioz në raport me afatin 20 vjeçar. Ndërsa pika 1.2, duhet të riformulohet dhe të sqarohet, se në ngastrën kadastrala P-70202016-02356-1 në sipërfaqe prej 1058 m<sup>2</sup> ekziston një ndërtesë në bashkëpronësi me sipërfaqe e cila duhet të specifikohet dhe qartësohet saktë. Përndryshe kështu siç është formuluar pika 1.2 edhe mund të jetë lajthitje për MAPL. Më, 31 janar 2019, hartuesi ia sjelli kuvendit Propozim-vendimin me arsyetimin se është interes i komunës afati 40 vjeçar. Kuvendi vendosi që afati të jetë 99 vite, tani e kemi përpara një propozim për 20 vite. Në arsyetimin e hartuesit për këtë çështje kërkohet

debat publik, gjë që e përkrahim. Ndoshta kjo po ndodh për shkak se, komuna nuk e ka një Strategji për Zhvillim Ekonomik.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - tha se disa anëtarë të kuvendit atë ditë kur është votuar për dhënien e pronës në shfrytëzim sikur kanë qenë të hutuar. Pastaj shtoi se gati në të gjitha mbledhjet e kuvendit po kemi pika që kanë të bëjnë me dhënien e pronës në shfrytëzim, andaj përsëriti se televizioni i cili ka qenë i vendosur në sallën e kuvendit e që tani nuk është duhet të rivendoset për faktin se në të do të publikohen shumë fakte që kanë të bëjnë me kryetarin e komunës dhe udhëheqësin e komunës, por edhe disa elemente tjera.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - pasi i mbështeti diskutimet e parafolësve, shtoi se pika e gjashtë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me dhënien e pronës në shfrytëzim në mbledhjen e kaluar të kuvendit ishte aprovuar në mënyrë unanime, pas një debati konstruktiv dhe gjithëpërfshirës. Tutje vlerësoi se është një kohë e shkurtër, prej aprovimit të këtij vendimi dhe në këtë rast nuk kemi ndryshim të rrethanave që do të determinonin ndryshimin e afatit të dhënies së kësaj prone në shfrytëzim. Përveç nëse dikush ka qëllime personale ndaj personave të caktuar për të cilët ju mendoni se do ta kenë në dispozicion këtë pronë. Pastaj vlerësoi se dhe bëri të ditur se kryetari i komunës është kryetar i të gjithë qytetarëve dhe shtoi se asnjëherë prej përfundimit të luftës e këndeje nuk ka pasur kesi lloj tretmani ku njerëzit të shikohen në mënyrë programore apo partiake, e në këtë rast kryetari i komunës është duke futur një frymë të keqe. Lidhur me këtë ai ceku se po tentohet në këto forma të ndryshohet bindja e anëtarëve të kuvendit dhe cilat janë ndryshimet që për një kohë kaq të shkurtër të ndryshohet ky vendim apo ka tendenca personale ndaj dikujt. Pastaj vazhdoi duke vlerësuar se ka pritur nga shefi i grupit si dhe kryetari i degës së LDK-së që të marrin përsipër këtë çështje dhe të reflektojnë e mos të merren kesi lloj vendimesh skandaloze. Kryetari i komunës është duke mbjell një frymë të keqe politike, frymën e përçarjes dhe kjo ka mundësi që të instalohet edhe në të ardhmen që të vendoset fryma e revanshit dhe e hakmarrjes personale dhe politike në të ardhmen, gjë të cilën PDK dega në Vushtri nuk e ka ndjekur kurrë dhe nuk dëshiron që ajo të ndodh as tani. Andaj lidhur me këtë ai kërkoi që kjo pikë të del në votim dhe të hiqet nga rendi i ditës në tërësi.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - ceku se lidhur me Propozim-vendimin për dhënien e pronës në shfrytëzim nuk ka pasur votim unanim për faktin se ajo dhe një anëtare tjetër kanë abstenuar, andaj kërkoi që kjo të përmirësohet. Për më tepër ajo është e mendimit që kjo pikë të futet në rend të ditës për shqyrtim, ashtu që të shikohet mirë se çka po votohet për faktin se secili duhet ta ketë ndërgjegjen e pastër për atë që voton dhe merr vendim.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** - tha se qëndrimi i grupit kuvendar të LDK-së është që kjo pikë të futet në rend të ditës dhe e njëjta të shfuqizohet.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se nga diskutimet po shihet se anëtarët e kuvendit për pikën që po bëhet fjalë kanë qenë në lajthitje, sepse kjo pikë nuk ka qenë e përgatitur si duhet, andaj kërkoi që herëve tjera të jepen sqarimet e duhura ashtu që kuvendi të marrë vendime të ligjshme. Pastaj vlerësoi se duhet të konstatohet se ka pasur shkelje të ligjit apo të ndonjë akti tjetër në rastin e aprovimit të vendimit në mbledhjen e kaluar dhe nëse nuk ka pasur shkelje, atëherë ai personalisht është që të mbetet në fuqi vendimi nga mbledhja e kaluar për dhënien e pronës në shfrytëzim. Në fund ai kërkoi që një parcelë kadastrale e cila është dhënë në shfrytëzim afarist për dhjetë (10) vite në fshatin Stanoc, t'i zgjatet afati në katërdhjetë (40) vite.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - kërkoi ne emër të grupit kuvendar të LDK-së, që në kuadër të pikës 6 të futet në rend të ditës edhe parcela kadastrale Nr.70202016-02356-1 me sipërfaqe prej 1058 m<sup>2</sup>, pronë kjo e cila në mbledhjen e kaluar ishte dhënë në shfrytëzim për 99 vite me destinim për ndërtim të lartë. Në këtë relacion vlerësoi se komuna nuk ka kurrfarë interesi ta jap këtë pronë

në shfrytëzim pasi që komunës i mungon prona komunale për realizimin e shumë objektivave tjera. Andaj kërkoi që ky vendim të shfuqizohet dhe ajo pronë t'i mbetet komunës.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së** - sqaroi se parcela kadastrale e cila është dhënë në shfrytëzim për ndërtim të lartë, aktualisht ekziston një ndërtim prej 4 etazheve, dhe për këtë kemi një peticion të atyre banorëve, të cilët kanë kërkuar që ai objekt të rregulloret pasi i njëjti ndodhet në gjendje të rëndë, andaj për këtë arsye kjo pronë është dhënë në shfrytëzim.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** - kërkoi që pika e gjashtë të hiqet nga rendi i ditës, pasi në mbledhjen e kaluar është marr vendimi i ligjshëm dhe i njëjti është konfirmuar nga mistrria gjegjëse.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LVV-së kërkoi që pika 6 të mbetet në rend të ditës dhe e njëjta pronë të jepet në shfrytëzim për 20 vite.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - kërkoi nga kryesuesi i kuvendit, por edhe nga drejtorët e drejtorive, të cilët sjellin pika për çështje të caktuara në kuvend që t'i japin sqarimet e duhura dhe adekuate ashtu që kuvendit t'i mundësohet marrja e vendimeve të ligjshme dhe të drejta. Tutje shtoi se kur bëhet fjalë për pronën komunale e cila jepet në shfrytëzim, atëherë duhet të kemi sqarime të nevojshme sa i përket numrave të parcelave dhe lokacionit se ku gjinden ato prona.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - njoftoi kuvendin lidhur me pikën 6 të rendit të ditës, duke sqaruar se parcela e cila është evidentuar në propozim-vendim ka të bëjë me pronë që ndodhet afër "Urës së gurit". Pastaj shtoi se ajo pronë është dhënë në shfrytëzim në mandatin e kaluar për një periudhë të caktuar kohore, dhe në atë pronë siç dihet është ndërtuar një objekt hotelier. Ai ceku se për të nuk është me rëndësi se kush e shfrytëzon atë pronë, porse si ko incidencë është se atë pronë e shfrytëzon një ish-drejtor i Komunës së Vushtrrisë. Kjo parcelë dhe parcela tjera, si dhe zhvillimi ekonomik nuk varet nga individë të caktuar e as nga subjekte të caktuara politike, pa marrë parasysh ngjyrimet politike dhe partiake. Mandej ai vlerësoi se të gjitha parcelat e pronës komunale, janë pasuri e komunës, të cilat do të shfrytëzohen vetë për interes të përgjithshëm sipas ligjit në fuqi. Në këtë kontekst ai bëri të dituar se biznesi i cili aktualisht e ka në shfrytëzim këtë pronë paguan 200 € qira Komunës së Vushtrrisë. Në bazë të kontratës e cila është në dispozicion të secilit anëtar të kuvendit, secili që dëshiron mund të ketë qasje në procedurën e dhënies së kësaj prone në shfrytëzim dhe për çështje tjera. Lidhur me këtë pronë në mbledhjen e kaluar kuvendi ka marrë një vendim që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 99 vite, dhe tani është ofruar propozimi që ky afat të bëhet për 20 vite, dhe çështja e marrjes së këtij vendimi bie në kompetencën ekskluzive të Kuvendit të komunës. Në mbledhjen e kaluar ishte propozuar fillimisht që afati i dhënies në shfrytëzim të kësaj prone të jetë 40 vite, por kuvendi kishte vendosur që pronën ta japë për 99 vite, në këtë rast kemi vërejtur se nuk është shterur debati, dhe pasi që kjo çështje është vendosur shumë prej anëtarëve të kuvendit kishin deklaruar se janë konfuzë për atë se çfarë kanë votuar. Tani në këto rrethana vendimi i takon kuvendit, dhe çfarëdo vendimi që kuvendi do ta merr, qeveria komunale është e gatshme që ta zbatojë, por komuna është e gatshme që të zhvillojë edhe projekte tjera në atë pronë. Pastaj shtoi se në këtë mbledhje kuvendi, do ta votojë një vendim paraprak, mandej është komisioni ai i cili do të zhvillojë procedurat e ankandit publik, duke vlerësuar ofertën më të favorshme për komunën, dhe sërish është kuvendi ai që do ta merr vendimin final. Andaj për më shumë lidhur me këtë çështje ai vuri në konsideratë se për këtë pronë nuk është shterur debati dhe ceku se nëse është e nevojshme dhe ka vullnet, kjo çështje mund të shkojë edhe në debat publik me qytetarë. Gjithashtu vlerësoi se nëse kuvendi do të ndante mjete financiare për atë pronë, aty do të mund të zhvillohej një projekt për bërjen e një Qendre ditore për të moshuarit dhe kjo do të ishte një ide shumë e mirë. Në fund tha se në kaluarën nuk është mbrojt interesi i komunës sa i përket asaj pronë, për faktin se qiramarrësi i ka paguar komunës vetëm 200 €, ndërsa e ka shfrytëzuar energjinë elektrike të komunës.

**Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit** - duke paraqitur vërejtje në adresë të Drejtorisë së Kadastrit, lidhur me çështjen e dhënies së pronës në shfrytëzim ceku se është çështje shume e ndieshme. Pastaj bëri të ditur se në mbledhjen e kaluar kishte kërkuar sqarime lidhur me pikën që tani po kontestohet, por nuk kishte marrë informacionet e nevojshme dhe kështu kishte pasur dilema sa i përket aprovimit të atij vendimi.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së** - fillimisht shprehi keqardhje për anëtarët e kuvendit që nuk e kanë pas të qartë për atë që është vendosur në mbledhjen e kaluar. Më tutje filloi sqarimet për pronat si “Ura e gurit”, Gjykata e vjetër, Stadiumi i gomës dhe për banesën kolektive përball Shkollës së policisë, që janë diskutuar në KPF, ku tha se propozimi që ka qenë i shkruar nga qeveria për 40 vite, ndërsa kuvendi ka vendosur që këto prona të jepen në shfrytëzim për 99 vite. Megjithatë ai theksoi se kishte ofruar edhe një propozim që është i ligjshëm si propozimi i kaluar dhe sipas tij ky është vetëm një vendim paraprak për orientimin e procedurave të tjera.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** – tha se po tentohet që anëtarët e kuvendit të vihen në lajthitje dhe shtoi se pika e gjashtë e rendit të ditës duhet të hiqet nga agjenda, ashtu që të mbetet në fuqi vendimi i datës 31.1.2019 për dhënien e pronës në shfrytëzim për 99 vite.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – tha se është shumë e qartë, se shpeshherë anëtarët e kuvendit, bien në lajthitje për shkak të paqartësive që krijohen, sidomos kur kemi të bëjmë me dhënien e pronës në shfrytëzim. Më tutje shtoi se në mbledhjen e kaluar i kishte pasur dilemat e tij sa i përket çështje së pronës. Në këtë kontekst vlerësoi se në të ardhmen kur do të ketë paqartësi ai do të rezervohet nga votimi pa u siguruar se për çfarë është duke votuar. Në fund ai ceku se herëve tjera kur vendoset për dhënien e pronës në shfrytëzim, atëherë duhet që gjërat të qartësohen përmes elaborateve dhe skicimit të parcelave në lokalitete ku gjenden ato para se kuvendi të marrë vendim.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se ndonjëherë njeriu duke lexuar dokumentet beson se ato i ka analizuar, por në fakt ai mund edhe të jetë në lajthitje mbi faktet para se të vendos mbi atë çështje. Pastaj u sqarua para kuvendit, se në kampanjën paraelektorale ishte prononcuar për pronën e cila ndodhet në perimetrin e “Urës së gurit”, por megjithëkëtë ai nuk është duke ndjekur agjendë personale apo partiake. Mirëpo përkundër këtyre ai ndanë mendimin se ajo pronë nuk është menaxhuar në mënyrën më të mirë duke u mbrojtur interesi i komunës, edhe pse krahasuar me të kaluarën ai vend është më mirë për faktin se në të kaluarën ajo pronë ka qenë shndërruar në deponi mbeturinash, pavarësisht fakti se aty nuk është realizuar interesi i përgjithshëm i qytetarëve. Pastaj ai vlerësoi se në mbledhjen e kaluar qeveria komunale kishte sjellë për kuvend një propozim për këtë pronë që ajo të jepet në shfrytëzim për 40 vite, dhe kuvendi pa një debat substancial kishte vendos që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 99 vite, andaj për këtë ai kërkoi që kjo çështje të futet në rend dite, të shteret debati dhe pastaj kuvendi të marrë një vendim. Në fund ai deklaroi se si kryetar komune nuk e mbështet qëndrimin që ajo pronë të jepet në shfrytëzim për 99 vite, por që afati të jetë 20 vite.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - tha se është e vërtetë që po tentohet të vihen në lajthitje anëtarët e kuvendit, për faktin se vendimi i marrë në mbledhjen e janarit është plotësisht i ligjshëm dhe i vërtetuar nga ministria gjegjëse. Pastaj ceku propozimi që vendimi paraprak të ndryshohet në mënyrë parciale është tentim që t’u qitet hi syve dhe t’i lajthitin anëtarët e kuvendit, për më tepër ai pasi çështja kështu ai propozoi që parcela ku ndodhet gjykata e vjetër të hiqet nga rendi i ditës dhe që ajo pronë të mbetet në pronës komunale, ku do të mund të shfrytëzohej si shtëpi për qëndrim ditor të të moshuarve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të procedohet pika e rendit të ditës që ka të bëjë me ndryshimin e afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale në fshatin Stanoc i Epërm.

**Para votimit të rendit të ditës kuvendi votoi për pikën e gjashtë (6) ku me 11 vota “për” dhe 19 vota “kundër” u vendos që pika e cekur të mos hiqet nga rendi i ditës.**

***Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës kuvendit pas votimit me 22 vota “për” aprovoi këtë:***

## **R E N D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të komunës, i datës 31 janar 2019;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018;
3. Shqyrtimi i kërkesës për caktim të dy anëtarëve në komisionin për ndarjen e bursave, nga përbërja e kuvendit;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e subvencioneve;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtim të kërkesave, për ndarje të shtëpive të banimit;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër 01Nr.22/19 i datës 31.1.2019;
7. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për punën gjatë vitit 2018;
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018/2019;
9. Shqyrtimi i draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale nr. 278/15, e datës 30.12.2015 (**shqyrtimi i parë**);
10. Shqyrtimi i draft-rregullores për plotësimin e Rregullores për dhënien e dekoratave (**shqyrtimi i parë**);
11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018;
12. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpalljen e ankandit publik për shitjen e materialit të Qendrës së kulturës “Hasan Prishtina” dhe Palestrës së sporteve “Jeton Terstena- TOTA”;
  - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për anulimin e pjesshëm të vendimit të Kuvendit me Nr.362/18 i datës 27.12.2019.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 31 janar 2019.

**Bahrije Ademi - Murati, anëtare e kuvendit** - pyeti se përse disa paragrafë nga diskutimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit që i referohen diskutimit të anëtarit të kuvendit z.Nezir Klinaku pse janë shënuar me shkronja të mëdha.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – i sqaroi anëtares së kuvendit se vetëm atëherë kur janë përmendur drejtoritë dhe gjërat me rëndësi që i referohen tabelave të buxhetit, projekteve dhe shpenzimet sipas drejtorive aty kemi të bëjmë me tituj, dhe ato janë theksuar me shkronja të mëdha.

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 31.1.2019 .*

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018.

**Bahrije Ademi - Murati, anëtare e kuvendit** - gjatë shqyrtimit të raportit të policisë kërkoi raport më të detajuar rreth substancave narkotike dhe shtimin e sigurisë nëpër shkolla, duke shoshitur në mënyrë krahasimore veprat penale kundër narkotikëve, si dhe shkaqet që shtyjnë në këto fenomene devijante, si dhe kërkoi që këto forma të krimit të evidentohen në raport.

**Faton Shabani - anëtar i kuvendit** - tha se nga mësimdhënësit e shkollave të mesme, si në gjimnaz, ashtu edhe në shkollat teknike e profesionale, dyshohet se nxënës që vijnë në mësimet në këto shkolla, përdorin substanca narkotike dhe bëhet blerja dhe shitja e këtyre narkotikëve brenda objekteve shkollore dhe brenda oborreve të këtyre shkollave. Më saktësisht, dyshimet që përdorimi i narkotikëve bëhet në banjat e objekteve shkollore. Normalisht, që ne nuk kemi informata nga zyrtarët policorë, sepse as në raportin e policisë nuk përmendet ndonjë rast i zbuluar. Për këtë pyeti se a janë kaq të sofistikuar këta përdorues të narkotikëve që nuk po mund të zbulohen apo këto informata janë të pasakta? Një shqetësim që po i brengos disa prind në komunën tonë, e që unë kam pas rast t'i takoj personalisht, është që në disa lokale të komunës sonë fëmijët e tyre po e luajnë një lojë kompjuterike e quajtur "fortnite", që sipas informatave që i kam për atë lojë, është një lojë në të cilën bëhen vrasje të personazheve në të. Pra, frekuentues të këtyre lokaleve janë fëmijët e moshës minore nga 10 deri në 16 vjeç. Gjithnjë sipas informatave që kam, kjo lojë po i bën fëmijët arrogantë, agresivë, depresivë, të paimterësuar për mësimet, po iu krijon sjellje të pahijshme në raport me prindit, po i bën të pashoqërueshëm me bashkëmoshatarët, dhe po iu shkaktohen probleme edhe në shikim, por edhe në pagjumësi. Pra, kemi të bëjmë me një varg të problemeve që po iu shfaqen fëmijëve, e që po rrezikon të kalojnë në varësi të kësaj loje, kurse lidhur me këto ai pyeti: a është policia përgjegjëse për monitorimin e këtyre lokaleve? Nëse PO, a ka policia informata për këto lokale se ku janë dhe çfarë ndodh në to?. A mund të bëhet ndonjë mekanizëm koordinues mes policisë, prindërve dhe shkollave që të sqarohet shqetësimi i prindërve të komunës sonë?

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se në raportin e policisë janë theksuar 17 raste të dhunës në shkolla, njëri prej tyre është shantazh, kurse pyeti komandantin e policisë se vepra penale shantazh a ka të bëjë në raportin nxënës-mësimdhënës, apo nxënës-nxënës ose nxënës-prindër, nëse këto të dhëna nuk janë konfidenciale.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** - pasi e përgëzoi për punën dhe nivelin e lartë të përgjegjësisë policinë e Kosovës, kërkoi nga komandanti i stacionit policor që gjatë mbremjes të rritet patrullimi i policisë në fshatin Maxhunaj për shkak se ka pasur disa vjedhje kohëve të fundit.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - përshëndeti dhe falënderoi policinë dhe komandantin e policisë z. Alidemaj dhe theksoi se gjatë vitit 2018 ka pasur rënie të krimit dhe ftoi qytetarët që të bashkëpunojnë ngusht me policinë e Kosovës dhe të punojmë së bashku për një siguri më të madhe.

**Muhamet Alidema, komandant i Stacionit Policor në Vushtrri** - në fjalën e tij para kuvendit, theksoi se gjatë vitit 2018 në Komunën e Vushtrrisë çështja e sigurisë ka qenë e mirë në përgjithësi. Këtë e kemi arritur nga bashkëpunimi me qytetarë dhe nga puna e madhe e policisë së stacionit tonë po edhe nga bashkëpunimi me institucionet tjera relevante në regjionin tonë. Viti 2018 mund të cilësohet si njeri ndër më të mirët në 5 vitet e fundit në rastet e zgjedhura dhe të lajmëruara. Shumë raste të dërguara në gjykatë nga policia e Kosovës nuk janë trajtuar për shkak të mungesës së hapësirës nga gjykata, kështu që nga viti 2008 janë trajtuar shpeshherë vetëm rastet urgjente u



shpreh Alidema. Lidhur me shqetësimin e disa anëtarëve të kuvendit në lidhje me moszbardhjen e rasteve ceku se gjatë vitit 2018 prokuroria që nga vendosja në Mitrovicë ka shqyrtuar shumë raste dhe ka ndikuar për të mirë edhe në punën tonë. Për rastet në Maxhunaj dhe në fshatra tjera po edhe në qytet për vjedhje kemi arritur sukses në kapjen e tyre, kurse kemi vetëm një rast me fatalitet në fshatin Stanoc në rrugën e cila është rrugë regjionale dhe nuk menaxhohet nga ne. Në Komunën e Vushtrrisë nuk ka pasur asnjë rast të vrasjes, ka pasur lëndime të rënda, mirëpo asnjë me fatalitet. Sa i përket narkotikëve ne si stacion në bashkëpunim me njësitë tjera kemi marrë masa ndaj këtyre dukurive, ku kemi pasur 19 raste dhe janë arrestuar 28 persona dhe shumica nga ta janë përdorues. Në lidhje me pyetjen se a përdoren në shkolla, ne vetëm një rast e kemi pasur gjatë vitit të kaluar dhe prezenca e policisë civile në shkolla ka ndikuar shumë në rënien e kësaj dukurie. Policia e Kosovës bën kontrolle të shkollave në bazë të urdhrat nga gjykata dhe informacionet që na vinë. Së bashku me DKA-në në Vushtri dhe me drejtorët e shkollave do të vazhdojmë kontrollet nëpër shkolla.

3. Shqyrtimi i kërkesës për caktim të dy anëtarëve në komisionin për ndarjen e bursave, nga përbërja e kuvendit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi Lorik Maxhunin për anëtar të komisionit për bursa.

**Bahrije Ademi - Murati, anëtare e kuvendit** - propozoi Gresa Mulin për anëtare të komisionit për bursa.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2019, ka shqyrtuar kërkesën për caktimin e dy anëtarëve në komisionin për ndarjen e bursave, nga përbërja e kuvendit dhe konform nenit 7 të Rregullores për Ndarjen e Bursave Nr.86/15 e datës 30.4.2015, ka aprovuar propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të këtij komisioni nga radhët e kuvendit, dhe atë znj. Gresa Muli nga radhët e pozitës, kurse z. Lorik Maxhuni nga radhët e opozitës.**

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e subvencioneve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të PDK-së e mbështeti ndarjen e subvencioneve dhe transfereve për vitin 2019 dhe propozoi për shëndetësi rritjen e fondit nga 22,000.00 € në 29,000.00 € ndërsa financimi i OJQ-ve 20,000.00 € për arsye se shëndetësia ka shumë nevojë për fonde dhe shpresoj të hasim në mirëkuptim nga të gjithë.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHMS-së** - tha se janë të interesuar ta fuqizojnë “Handikosin” për arsye se kryen shërbime për fëmijët me nevoja të veçanta dhe gjysmën e këtij buxheti për OJQ shkon tek ta. Kurse pjesa tjetër shkon për organizatat e dala nga lufta dhe ndonjë shoqatë me ndonjë projekt nga fusha e shëndetësisë publike, komunitetit apo vetëdijesimit në shëndetësi, kurse tha se ndarja e buxhetit është e drejtë për shkak të mundësive buxhetore që i kemi.

**Ymer Harandinaj, anëtar i kuvendit** - bëri të ditur se në parim e mbështesim ndarjen e subvencioneve. Pastaj pati një kërkesë për DA-në që asnjë fëmijë me nevoja të veçanta mos të

mbetet pa transport. Si rast e përmendi Ensar Sami Caka, të cili nuk po i sigurohet udhëtimi për në Mitrovicë dhe familja nuk ka mundësi ta mbulojë shpenzimin.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - lidhur me fondin për bashkëfinancim me donatorë për familjet pa strehë ku janë planifikuar 15,000.00 €, pyeti se a janë të mjaftueshme për 20 familje siç janë planifikuar të ndërtohen këto shtëpi me marrëveshje me shoqatën “Jetimat e Ballkanit”.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - njoftoi se do të kërkohet autorizimi nga ana e kuvendit që mjetet financiare që gjenden në zyrën e kryetarit të shfrytëzohen për këtë projekt, ndërsa këto mjetet tjera do të mund të përdoren për financimin e ndonjë projekti nga ndonjë OJQ ndërkombëtare në formën e bashkëfinancimit me donatorë për ndërtim të shtëpive. Më tej sqaroi se tendenca është që të rritet numri i shtëpive pasi që kërkesa për strehim është shumë e madhe.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** - tha se e mbështesin propozimin për ndarjen e subvencioneve, pasi ato janë ndarë në mënyrën më të mirë të mundshme.

**Afrim Namani, drejtori i DA-së** - theksoi se vitin e kaluar kanë qenë 9,000.00 € për transport për fëmijët me nevoja të veçanta dhe secili që ka aplikuar në drejtori është subvencionuar. Sa i përket fëmijës nga Stanoci me udhëzim administrativ është se transportin e tyre e bën qendra burimore nëse nuk është konviktor. Nëse është fëmija konviktor shpenzimet i mbulon komuna. Këtë vit për dallim nga viti i kaluar janë 1,000.00 më shumë për këtë kategori.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:**

**1. Mjetet financiare të buxhetit të komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2019 në shumë të përgjithshme prej 192,914.00 €, shpërndahen sipas pozicioneve të cekura si më poshtë:**

**1.1 Zyra e Kryetarit:**

1.1.1 Subvencione për dekorata .....	2,000.00 €
1.1.2 Subvencione për raste të veçanta.....	6,000.00 €
Gjithsej.....	8,000.00 €

**1.2 Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale:**

1.2.1 Ndihmë për strehim – qiratë e banimit .....	20,000.00 €
1.2.2 Ndihmë për shërim.....	22,000.00 €
1.2.3 Ndihmë me zahire familjeve skamnore.....	6,000.00 €
1.2.4 Financim të OJQ-ve.....	27,000.00 €
1.2.5 Bashkëfinancim me donatorë për familje të pastrehë.....	15,000.00 €
Gjithsej.....	90,000.00 €

**1.3 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:**

1.3.1 Botimi i Librave publikimeve .....	3,000.00 €
1.3.2 Financimi i OJQ-ve.....	49,500.00 €
1.3.3 Teatri i qytetit.....	7,500.00 €
Gjithsej.....	60,000.00 €

#### 1.4 Drejtoria për Arsim:

1.4.1	Bursa për studentë.....	18,460.00 €
1.4.2	Përkrahje e nxënësve dhe studentëve për aktivitete të lira.....	6,454.00 €
1.4.3	Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta.....	10,000.00 €
	Gjithsej.....	34,914.00 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Arsim dhe Zyra e kryetarit të komunës

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtim të kërkesave, për ndarje të shtëpive të banimit.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - sqaroi marrëveshjen me shoqatën “Jetimat e Ballkanit” ku mes tjerash sqaroi se komuna mbulon shpenzimet e qirasë për 15 familje në nevojë. Shpresojmë që kjo marrëveshje të lehtësojë sadopak gjendjen e rëndë të strehimit në komunën tonë. Duam që të gjithë së bashku ne si pozitë dhe si opozitë, si dhe shoqëria civile së bashku të bëjmë zgjedhjet më të mira për këto familje dhe të kemi një transparencë në maksimum për këto raste.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi Rrezarta Krasniqin për anëtare të komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e shtëpive të banimit.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - kërkoi që në vendim të përfshihet shumica e cekur për 22 shtëpi prej 110,000.00 €.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - tha se gjatë zbatimit të këtij projekti ka drojën se do të dalin pengesa për faktin se një shumë e mjetëve financiare janë paraparë nga investimet kapitale, dhe dihet fakti se ndërtimi i shtëpive bëhet nga kategoria e subvencioneve, andaj këtu do të ketë probleme sepse ka pengesa ligjore në kuptimin se mjetet financiare të dedikuara për investime kapitale nuk mund të shfrytëzohen në kategorinë e subvencioneve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - kërkoi që të bëhet një përmirësim tek pika 4 e vendimit, ku vendimin për aprovimin e kërkesës për ndërtim të shtëpisë duhet ta merr komisioni, ndërsa ta nënshkruajë kryetari i komunës. Për anëtar të këtij komisioni propozoi Kushtrim Hysenin.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - njoftoi se është kërkesë e donatorit që të veprohet kështu, ndërsa për ta rritur nivelin e transparencës së këtij procesi ai shprehu vullnetin dhe gatishmërinë që lista përfundimtare e këtij procesi të silltet në kuvend. Në fund sqaroi se anëtarët e tjerë do të caktohen me shkresë nga ana kryetarit të komunës, përfaqësues të ekzekutivit komunal, shoqëria civile dhe shoqata “Jetimat e Ballkanit”.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:**

1. Miratohet Marrëveshja për bashkëfinancim nr. 82/19, dt. 31.1.2019 e lidhur në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqatës bamirëse “Jetimët e Ballkanit” për ndërtim të njëzet e pesë (25) shtëpive për banim për familje në gjendje të rëndë sociale në Komunën e Vushtrrisë, të cilat nuk e kanë të zgjedhur çështjen e banimit, prej të cilave, për njëzet e dy (22) do të participojë komuna me nga pesë mijë (5000.00 €) për secilën shtëpi, ndërsa tri (3) shtëpi me financim vetëm nga shoqata.

2. Pagesa e mjeteve në shumën e cekur si në pikën një (1) të këtij vendimi, do të bëhet nga buxheti i komunës, investime kapitale, kodi 644160-1933479, “ Ndërtimi i objekteve të banimit për raste sociale me bashkëfinancim me donatorë”.

3. Lidhur me këtë çështje themelohet komisioni për shqyrtim të kërkesave për ndarje të shtëpive për banim në këtë përbërje:

- 3.1 Rrezarta Krasniqi, kryesuese e komisionit, nga kuvendi i komunës;
- 3.2 Kushtrim Hyseni, anëtar, anëtar i kuvendit të komunës;
- 3.3 Sylejman Mehulli, anëtar, nga ekzekutivi i komunës;
- 3.4 Isak Hyseni, anëtar, nga shoqëria civile;
- 3.5 Halil Jonuzi nga Shoqata bamirëse “Jetimët e Ballkanit”

4. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë pranimin e kërkesave të qytetarëve të komunës dhe shqyrtimin e tyre, ndërsa pas propozimit nga komisioni, vendimin përfundimtar për përfitim të donacionit – ndërtimit të shtëpisë, paraqitësit të kërkesës, do ta merr Kryetari i komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i komunës dhe komisioni.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër 01Nr.22/19 i datës 31.1.2019.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - propozoi që parcela nga pika 1.1 e vendimit (prona tek “Ura e gurit”) të jepet për 40 vite në shfrytëzim me arsyetimin se shfrytëzuesi i deritashëm ka investuar në rregullimin dhe mirëmbajtjen e saj.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - propozoi që parcela 1.1 të jepet për 20 vite, kurse 1.3 për 40 vite, pasi që shumica absolute e grupit të LDK-së ishte që prona tek “Ura e gurit” t’i kthehet në pronësi komunës, por meqë u konstatua se është e vështirë që të menaxhohet ajo pronë, ai propozoi që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 20 vite.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se si Lëvizje për Bashkim, janë që kjo çështje të vendoset në saje të propozimit të parë të kryetarit të komunës që ka qenë në fillim, që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 40 vite.

**Bahrije Ademi - Murati, anëtare e kuvendit** - propozoi opsionin që prona tek gjykata të jepet për 40 vite, ndërsa prona tek “Ura e gurit” për 20 vite.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - në emër të PDK e përkrah idenë për 40 vite për të dyja parcelat dhe shtoi se nuk duhet të krijojmë shembull të keq për investitorët potencial. Ai bëri thirrje për

maturi dhe racionalitet në votim, duke votuar për 40 vite për të dyja pronat ashtu siç propozoi anëtari i kuvendit nga radhët e LVV-së z. Ali Januzi.

*Lidhur me këtë propozim-vendim siç shihet nga diskutimet pati dy versione, i parë, që të dy parcelat të jepen në shfrytëzim për 40 vite i emërtuar si propozimi i Ali Januzit, për këtë version votuan 12 “për”, 14 “kundër” dhe 1 votë “abstenim”.*

**Andaj pas përfundimit të debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi me 17 vota “për” nga “31” anëtarë të kuvendit sa ishin prezent në momentin e votimit u vendos me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet vendimi paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale 01Nr.22/19, dt.31.1.2019**

**2. Ndryshimi i vendimit paraparak në fjalë, bëhet në pikën 1.1 për sa i përket afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës: prej afatit 99 vite, në afatin e dhënies në shfrytëzim prej 20 vite, ndërsa te pika 1.3 e pikës 1 të vendimit të sipërcekur, ndryshohet afati i dhënies në shfrytëzim të pronës nga 99 vite në 40 vite.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se kuvendi i komunës aktualisht ka 33 anëtarë, pasi që dy anëtarë të kuvendit kanë dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit, andaj lidhur me këtë ai kërkoi nga Sekretaria e kuvendit që kur të dërgohet vendimi në MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë, të sqarohet se Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka 35 anëtarë (numri i përgjithshëm), por dy anëtarë të kuvendit kanë dhënë dorëheqje, dhe votimi me 17 vota “për” duhet të sqarohet se a paraqet shumicë të mjaftueshme për aprovimin e vendimit të sipërcekur. Në fund ai u zotua para kuvendit dhe para qytetarëve, se si qeveri e komunës nuk e kanë ndërmend që ta hedhin në ankand publik asnjërin nga këto prona për afat të shfrytëzimit për 99 vite. Lidhur me pronën tek “Ura e gurit” njoftoi se për këtë pronë është shkëputur kontrata në mënyrë të njëanshme nga qiramarrësi dhe ligjërisht me të përfunduar kjo kontratë, komuna ka të drejtë që këtë pronë ta regjistrojë në emër të saj në librat e pasurisë. Andaj shtoi se në dy mbledhje është debatuar lidhur me këtë çështje dhe për këtë është shterur debati, dhe se vullneti i kuvendit është që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 20 vite.

**7. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për punën gjatë vitit 2018.**

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit** - kërkoi që të bëhet ndalimi i reklamimit, të barnave dhe kompanive farmaceutike në hapësirat e institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Vushtrrisë. Tutje shtoi se këto kompani kanë shkaktuar bezdisje gjatë orarit të punës së mjekëve

dhe gjatë kontrollit të pacientëve. Për këtë ajo propozoi që në kolegjiun profesional të mjekëve aty të marrin pjesë edhe këto kompani dhe ata të marrin leje nga drejtoria kompetente për reklamim, por në asnjë formë mos të lejohet reklamim në ordinanca.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHMS** - tha se sa i përket propozimit të parë ne kemi ndaluar reklamimin e produkteve farmaceutike gjatë orarit të punës, kurse sa i përket propozimit të dytë ne me anë të një vendimi kemi sqaruar se nëse kolegjiun i doktorëve medoemos është i nevojshëm të njoftohet me një preparat farmaceutik do të organizohen takime të cilat do të shërbejnë në zhvillimin profesional të kolegjiunit.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - kërkoi nga anëtarja e kuvendit që nëse has në raste të tilla ta lajmërojë drejtorinë përkatëse për të marrë masat e duhura.

**Teuta Shartari, anëtare e kuvendit** - pasi lavdëroi punën e bërë nga Drejtoria e Shëndetësisë, kërkoi që të përmirësohet titulli shërbimi i dializës, të theksohet se kryhet transporti për këtë kategori dhe shërbimi kryhet në Mitrovicë. Më tej pyeti drejtorin e drejtorisë në fjalë, se a planifikoni rritjen e numrit të llojeve të analizave?

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHMS** - theksoi se janë duke punuar në mënyrë intensive që të rritet numri i analizave që kryhen në QKMF.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** - përgëzoi drejtorin për punën e bërë deri më tani dhe për raportin, duke theksuar se duhet motivuar punëtorët shëndetësorë. Propozimet e tij ishin që të shikohet mundësia buxhetore e rritjes së numrit të punëtorëve në QKMF.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHMS** - pasi falënderoi të gjithë për bashkëpunimin me Drejtorinë e Shëndetësisë kërkoi që të caktohet një ditë ku do të ndahen shpërblime për punëtorët shëndetësorë. Kurse sa i përket numrit të shërbyesve shëndetësorë jemi duke e bërë gati një kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë.

**Avdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit** - përgëzon punën e drejtorisë dhe kërkon numër më të madh të stafit, në mënyrë që të rritet cilësia e shërbimeve shëndetësore.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - kërkoi që materiali (informata) të publikohet në faqen e komunës që të kenë qasje edhe qytetarët.

## 8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018/2019.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - përgëzoi drejtorin e DA-së për përpilimin e raportit. Brenga e tij ishte sukse i nxënësve ku shprehi shqetësimin e rënies së nivelit të mësimit menjëherë pas përfundimit të ciklit fillor dhe kalimit në ciklin e mesëm të ulët dhe ende më shumë bie sukse i në nivelin e mesëm. Pastaj shqetësimi tjetër i tij ishte edhe rënia e vijueshmërisë në shkolla edhe përkundër reformave të bëra në fushën e arsimit. Pyetje për drejtorin e DA-së se çka do të ndërmerret nga kjo drejtori për përmirësimin e suksesit të nxënësve dhe ku qëndron problemi për këtë sukses.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - së pari e përgëzoi drejtorinë për informatën të cilën e ka hartuar, por shpreh shqetësimin për suksesin e nxënësve. Duke shfrytëzuar ligjin e vullnetarizmit të sillen studentët nga degë të ndryshme, si logopedisë ose psikologjisë që në një periudhë gjashtëmujore të merren me nxënësit që kanë problem në mësimnxënie dhe nxënësit me nevoja të veçanta t'i inkuadrojmë në shoqëri dhe nëpër klasa ku ta kenë nga një mësuese vetëm për ta. Shqetësim tjetër i ngritur nga ana e saj ishte mungesa e pajisjeve higjienike nëpër shkolla dhe mungesa e ujit në disa objekte shkollore.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** - bëri pyetje për drejtorin e DA-së për 5 nxënës të panotuar në nivelin fillor, 16 nxënës të panotuar në nivelin e mesëm të ulët dhe janë 6 nxënës në nivelin e mesëm, cila është arsyeja e mosnotimit të këtyre nxënësve.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - kërkoi që edhe informata nga DA të postohet në faqen zyrtare të komunës. Pastaj shtoi se kjo informatë pasqyron gjendjen reale në fushën e arsimit në komunën tonë, por të thuash e përgëzoj informatën është gjë e pakuptimtë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - theksoi se punësoria në shkollën “Lutfi Musiqi” është në të mirë të qytetit. Rreth kësaj punësorie shprehi shqetësimin për fillimin e punëve, më saktësisht rreth gurthemelit i cili është bërë në temperatura të ulëta. Pyetja e tij është se nëse në shtëpitë e juaja kishit bërë një investim 180,000.00 € a do ta bënit në temperatura -20 gradë. Po ashtu ceku edhe suksesin e dobët nga nxënësit si një shqetësim tjetër. Tutje vazhdoi duke theksuar edhe një dukuri e cila është përhapur ku mësimdhënësit hapin kurse private dhe obligojnë nxënësit t’i vijnë ato kurse për notë maksimale. Pastaj kërkoi nga DA që krahasimi për lëndët të dallojë nga gjimnazi “Eqrem Qabej” me shkollat teknike dhe profesionale ku do të përfshihen lëndët profesionale. Kemi raste në shkollat profesionale, disa mësimdhënës të cilët kanë përfunduar nivelin master dhe ju njihet ai nivel nga ministria dhe humbin nga 20 euro në muaj kur dihet se kemi një suficit mbi 103,000.00 € në vitin e kaluar, mirëpo ata nuk marrin pagesën sipas këtij kualifikimi. Kërkesë tjetër ishte që punëtorët teknik që janë në një kompani private edhe ata të trajtohen me ligjin e ri të pagave. Propozoi që të identifikohen nxënësit që nuk kanë mundësi të paguajnë udhëtimin, të ndahet një fond për ta ku së bashku me drejtorët dhe kujdestarët e klasave të identifikohen këta nxënës. Në fund pyeti DA-në se për vitin e ardhshëm a është llogaritur shujta dhe udhëtimi për mësimdhënësit.

**Melihate Basholli - Latifi, anëtare e kuvendit** - theksoi se krahasueshmëria na ndihmon ta shohim gjendjen reale në arsim. Pastaj ajo shprehu brengën e saj për suksesin e nxënësve dhe për mungesat e paarsyeshme, sidomos mungesat në orët e para dhe në orët pas pushimit të gjatë, si dhe theksoi edhe mungesën e teksteve për zhvillimin e kurrikulës së re, sidomos këto të gjuhëve të huaja, në ç’rast tekstet shpesh janë të papërshtatshme. Mandej ajo vlerësoi se mbajtja e ligjëratave nga OJQ-të bëhet në koordinim me mësimdhënësin, në ç’rast duhet të përpilohet së bashku ligjëratat me ta dhe të jenë të trajnuar mbajtësit e këtyre ligjëratave. Lidhur me këtë çështje ajo dha një shembull i cili praktikohet nga ligjëruesit dhe i cili nuk duhet të zë vend në këto leksione për nxënësit, për faktin se ashtu vetëm sa po shtrohet rruga që nxënësit tanë të futen në dukuri patologjike e devijante. Shembulli ishte: se mosha në të cilën fillohet konsumimi i cigares është ajo 13-14 vjeçare, pastaj se fillimi i konsumit të cigares është hapi i parë për të vazhduar me alkool dhe drogë, mandej se mosha kur mund të mendohet të lihen këto gjëra është mosha 40 vjeçare. Për këtë ajo vlerësoi se ky shembull nuk do të duhej t’i servohej nxënësve tanë.

**Afrim Namani drejtor i DA-së** - pasi që i falënderoi të gjithë anëtarët për vlerësimin e informatës u përgjigj në pyetjet e tyre, ku njoftoi se kanë filluar që nga viti i kaluar dhe vazhdon tutje rekrutimi i edukatorëve cilësorë dhe mundësia e punësimit të psikologëve dhe pedagogëve që do të ndihmonte në rritjen e mësimnxënies tek nxënësit. Duhet edhe dy vite për t’u plotësuar kurrikula e re edhe pse ne si DA nuk bëjmë politika, por i zbatojmë ato dhe vazhdimisht po mundohemi ta harmonizojmë programin me kushtet tona. Sa i përket pyetjes së Gresës ende nuk na ka ardhur asnjë rast për punë vullnetare. Sa i përket çështjes se pajisjeve higjienike ne kemi pasur një auditim në zyrën e DA-së dhe për këtë çështje ne do ta presim raportin e tyre, megjithatë ne do të punojmë në vetëdijësimin e nxënësve për mos-humbjen e pajisjeve higjienike. Numri i shkollave me mungesë të ujit është i vogël. Vitin e kaluar kemi bërë hapjen e pusëve për furnizim me ujë. Sa i përket nxënësve të panotuar në nivelin fillor asnjë fëmijë nuk e ka braktisur shkollimin, në nivelin

e mesëm të ulët kemi dy raste, ku njëri prej tyre ka probleme shëndetësore dhe në njërin familjarët nuk na lejojnë të futemi në oborr për ta mësuar arsyen. Arsyeja pse kualifikohen si të panotuar është edhe tek sistemi SMIA i MASHTIT ku nuk na jep mundësinë që nxënësit të cilët janë shpërngulur në qytete tjera apo jashtë shtetit ta largojmë mirëpo mbetet si i panotuar, kështu që këtë problem e kemi adresuar në ministri. Projekti për punëtorinë në shkollën e mesme teknike është projekt dyvjeçar edhe pse ka filluar si trevjeçar, mirëpo për shkak të ofertave dhe vendosja e gurthemelit në atë datë janë mbikëqyrur dhe mbikëqyret në vazhdim nga inxhinjerët. Sa i përket kurseve private nuk është në përgjegjësi të DA-së, por të inspektoratit të Arsimit që është në nivel rajonal. Krahasimi i suksesit vetëm në lëndët e përgjithësime është bërë si nivel i arsimit me lëndët e përgjithshme. Mospagesa e nivelit master është se disa nuk kanë mundësi ta vërtetojnë. Edhe pse e kam adresuar në ministri dhe kemi pasur buxhet, mirëpo ministria nuk e ka miratuar. Sa i përket teknikëve që paguhen nga kompanitë private, jam takuar me këta punëtorë, mirëpo organogrami i DA-së nuk e lejon këtë për shkak të numrit të kufizuar të punëtorëve. Sa i përket nxënësve që nuk kanë mjete për udhëtim është e rregulluar se çdo nxënës që një drejtim i ka 4 km e më shumë shpenzimet i mbulohen. Për mungesat në orën e parë dhe orën e katërt po mundohemi çdo ditë ta trajtojmë këtë problem ku në shkollat e mesme prindërit janë larg shkollave dhe ne kemi filluar të marrim masa për nxënësit me shumë mungesa. Mungesa e literaturës nuk është në dorën e komunës për kurrikulën e re. OJQ-të për ligjërata së pari marrin leje në MASHT pastaj ne ua japim lejen, kurse nuk ka dallim mes arsimit në fshat - qytet.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se informatat në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë pasqyrojnë gjendjen reale të cilën e kemi trashëguar nga mandatet e kaluara. Në këtë kontekst shtoi se gjendja në këto fusha nuk është e mirë, por përpjekjet për ta përmirësuar atë nuk mungojnë. Pastaj njoftoi se në bazë të një hulumtimi të bërë me afër 1500 respondentë del se vetëm 7 % e mjekëve i pastrojnë duart para dha pasi të përfundojnë një pacient. Në vazhdim ai vlerësoi se në fushën e shëndetësisë dhe të arsimit është investuar mjaft shumë në përmirësimin e infrastrukturës, por edhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve. Falë punës së mirë arsimit në komunën tonë sot ka partneritet me USAID-in amerikan dhe me Lux Dev për ngritje të cilësisë së arsimit në komunën tonë dhe atë me USAID-in amerikan ka partneritet gjimnazi i Vushtrrisë, kurse me Lux Dev ka lidhur partneritet Shkolla e Mesme Teknike "Lutfi Musiqi" ku në këtë rrafsh do të synohet të fuqizohet qendra e kompetencës. Andaj lidhur me këto të arritura askush nuk duhet të ketë xhelozitë dhe inate, por duhet t'i gëzohet sukseseve. Në këtë kontekst vlerësoi se ata që janë pjesë e sistemit edukativ-arsimor, duhet ta shikojnë suksesin e tyre personal me nxënësit, duke filluar nga suksesi në lëndën e tij mësimore pastaj nga sjellja e tyre me nxënësit dhe nxënëset. Informata për gjendjen në arsim nuk është dhe nuk duhet të shfrytëzohet për të bërë politikë, por është një pasqyrim i gjendjes që e kemi dhe i përpjekjeve që po bëhen për përmirësimin e gjendjes në arsim. Shumë objekte shkollore si qeveri i kemi gjetur pa ujë, por për këtë janë hapur puse dhe tani këto shkolla kanë furnizim me ujë. Lidhur me preparatet për mbajtjen e higjenes (shampon dhe sapun) nëpër shkolla ceku se kjo si ide është e mirë, por vështirë e realizueshme për faktin se në shkollat me 500 e 1000 nxënës kujdesi është i vogël dhe kjo do të mund të kthehej në një investim të kotë. Mandej ai apeloi për një bashkëpunim më të ndërsjellë mes strukturave të shkollave dhe Këshillit të prindërve në avancimin e procesit mësimor. Në saje të menaxhimit të mirë të fushës së arsimit, këtë vit është bërë e mundur që në gjitha shkollat amë të organizohet mësimi parashkollor pa financim nga prindërit, dhe në të kaluarën gjysma e fëmijëve nuk kanë shkuar në mësimin parashkollor sepse është dashur financimi nga ana e prindërve. Në fund tha se arsimit do mund të ecë përpara vetëm duke investuar dhe duke u kontrolluar cilësia e arsimit, ndërsa si rezultat i qeverisjes së mirë qeveria komunale ka bërë ngritjen e investimeve kapitale në masën prej 80 % në



fushën e shëndetësisë dhe 43% në fushën e arsimit dhe kjo po bëhet me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës dhe cilësisë në këto fusha.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - tha se nga diskutimet dhe parafolësit u konfirmua se betoni lidhur me punëtorinë e shkollës teknike është vendosur në temperatura prej  $-20^{\circ}\text{C}$  dhe kjo edhe nëse përdoret aditivi si mjetet mbrojtës, prapë ka dyshime për qëndrueshmërinë e betonit në këto temperatura. Lidhur me këtë çështje ai kërkoi që të bëhen publike atestet e betonit lidhur me këtë punëtori, dhe që të njëjtat t'i ofrohen anëtarëve të kuvendit. Pastaj lidhur me infrastrukturën shkollore, bëri të ditur se me ardhjen në pushtet të PDK-së në Vushtrri, në vitin 2007 kanë filluar investimet në infrastrukturën shkollore, për faktin se në atë kohë mësimi është mbajtur edhe në 4 ndërrime por falë këtyre investimeve tani ka përmirësimi të jashtëzakonshëm në infrastrukturën shkollore.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se kur foli për higjienën nëpër shkolla nuk ka folur vetë sa për të thënë diçka, por e vërteta është se duhet të bëhen përpjekje që të sigurohen kushte për higjienë më të madhe për nxënësit, tani pasi kjo është shumë me rëndësi për shëndetin e fëmijëve tanë. Ajo pastaj vlerësoi se e përgëzoi drejtorinë e DA-së për punët që i ka bërë, por në fakt ajo nuk pret që të gjitha punët kjo drejtori t'i përfundojë brenda një viti. Lidhur me numrin e nxënësve që është kusht për renovimin e shkollave, ceku se kjo është e padrejtë, sepse në disa lokalitete siç është fshati Ceceli dhe Dumnice e Llugës kushtet nëpër shkolla janë në gjendje të mjerueshme.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së** - tha se pllaka e betonit mund të vendoset deri në  $-30^{\circ}\text{C}$ , në raste të caktuara kur vendoset aditivi, edhe në rastin konkret është vendosur një themel pllakë dhe vlerëson se nuk ka ndonjë problem që mund të shfaqet në të ardhmen.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar diskutimit të kryetarit të komunës, njoftoi se për 18 vite rresht ka punuar si bashkëpunëtor në organizatën Kreditimi Rural i Kosovës dhe për punë që bën aty ka pasur edhe një padi në Agjencinë Antikorrupsion dhe kjo është bërë me ndihmën e dikujt nga komuna dhe për këtë i kam parashtruar të gjitha dëshmitë se a ka konflikt interesi në punën që bën (këto informata janë zyrtare). Lidhur me prononcimet e tij shtoi se të gjithave iu qëndron pas, pasi që ato janë të vërteta, andaj ceku se është i gatshëm të ballafaqohet me gjithsecilin për të gjitha ato. Në fund ai tha se është zgjedhur nga qytetari dhe gjithherë do të punojë vetëm për të mirën e tij, pa u zbrapsur kurrë.

**9. Shqyrtimi i draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale nr. 278/15, e datës 30.12.2015 (shqyrtimi i parë).**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se vërejtjet dhe sugjerimet të cilat i ka bërë në Komitetin për Politikë dhe Financa, drejtorja i ka marrë për bazë dhe kjo është shumë mirë. Pastaj ai apeloi që të krijohen standarde të njëjta të hartimit të akteve juridike, ashtu që të kemi një teknikë unike të hartimit dhe zbatimit të akteve juridike në komunë.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së** - paraqiti sqarime sa i përket draft-rregullores në fjalë, duke shtuar se kjo rregullore ka kaluar në Zyrën ligjore të komunës për analizë. Tutje njoftoi kuvendin se ndryshimi i kësaj rregulloreje ka ardhur si rezultat i ndryshimeve dhe harmonizimit me disa udhëzime administrative. Pastaj ai bëri të ditur se harmonizimi i kësaj rregulloreje është bërë pasi që ky plotësim-ndryshim është sugjeruar edhe nga auditori i përgjithshëm. Në saje të këtyre ndryshimeve është bërë ndryshimi i mënyrës së pagesës së takës administrative dhe afati i pagesës dhe atë nëse lejet ndërtimore kalojnë vlerën 25,000.00 € atëherë pagesa mund të bëhet në tri këste brenda vitit, ndërsa në shumën mbi 80,000.00 € pagesa do të bëhet në katër këste, ndërkaq garancion për komunën do të jetë garancioni bankar që e sjell aplikuesi.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale me Nr.278/1, e datës 30.12.2015.

2.Diskutimi publik fillon nga data 6 mars 2019 dhe zgjat deri më 20 mars 2019.

3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që si propozues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2019.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi i draft-rregullores për plotësimin e Rregullores për dhënien e dekoratave (shqyrtimi i parë).

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - sa i përket draft-rregullores për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për Dhënie të Dekoratave, Lëvizja për Bashkim e përkrah fuqimisht dhe do ta japim kontributin tonë mes dy leximeve. Kështu siç ka ardhur në kuvend, konsiderojmë se ka të meta si e tillë. Së pari baza ligjore duhet të jetë: Neni 40 funksionimi i kuvendit të komunës, paragrafi 40.2 kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për, pika h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi. Pastaj, ka mangësi tjera të shumta në nenet e rregullores bazë, dhe duke vlerësuar se kjo rregullore ka nevojë për plotësim dhe ndryshim të më shumë neneve. Propozoi: 1. Të formohet një komision komunal prej 5 anëtarëve (nga kuvendi dhe ekzekutivi), për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për Dhënie të Dekoratave 01 Nr.186/2013 të datës 15 korrik 2013, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin e Komunës Nr.88/15, datë 30 prill 2015. 2. Kuvendi komunal të vendosë që në dokumentin final të bëhet spastrimi dhe lekturimi i tekstit.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - propozoi Nezir Klinakun për anëtar të komisionin për hartimin e Rregullores për Dekorata, nga ana e opozitës.

**Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit** - propozoi Faton Shabanin për anëtar të komisionit nga radhët e pozitës.

*Tre anëtarë tjerë të komisionit do të emërohen nga ana e kryetarit të komunës, duke përfshirë: Drejtorinë e Kulturës, Zyrën ligjore dhe shoqërinë civile.*

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

**1. Me këtë vendim formohet komisioni nga kuvendi i komunës dhe ekzekutivi komunal për hartimin e Rregullores për Dekorata në përbërjen si në vijim:**

- 1.1 Faton Shabani, anëtar i kuvendit;
- 1.2 Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit;
- 1.3 Alban Tahiraj, nga Zyra ligjore e komunës;
- 1.4 Izet Miftari, nga DKRS-ja, dhe
- 1.5 Blerim Ibrahimimi nga shoqëria civile.

**2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të ketë për obligim, hartimin e një teksti të spastruar të Rregullores për Dekorata, duke bërë harmonizimin e tekstit me rregulloren bazë për dekorata, me numër të protokollit 186/13 të datës 25.7.2013, si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënie të dekoratave me numër të protokollit 88/15 e datës 30.4.2015, pas hartimit të këtij drafti i njëjti do t'i nënshtrohet diskutimit publik.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018.**

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** parashtrroi pyetje për KKSB- se a kanë shqiptuar ndonjëherë ndonjë masë për fëmijët të kërkojnë lëmshë dhe që shesin ushqime impulsive gjatë orëve të mbrëmjes, si dhe a është shqyrtuar çështja e frekuentimit të fëmijëve të lokaleve kafiterive, dhe internet-kafeve pas orës 18:00.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - njoftoi se ka formuar një komision për hartimin e rregullores për parandalimin e kryerjes së punëve të rënda dhe mbrojtjen e fëmijëve, dhe për këtë është autorizuar edhe Drejtoria e Shëndetësisë, dhe ne presim që shumë shpejt kjo rregullore të vjen në kuvend për aprovim.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - kërkoi që të rritet siguria për faktin se niveli i sigurisë për nxënësit të cilët udhëtojnë është shumë i ulët pasi që ata kanosen nga qentë endacakë, andaj kërkoi që të ndërmerren masa para se të ndodhë ndonjë e keqe për ata nxënës.

12. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpalljen e ankandit publik për shitjen e materialit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” dhe palestrës së sporteve “Jeton Terstena- TOTA”;

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e materialit, i cili është larguar nga Qendra e kulturës “Hasan Prishtina” dhe nga kulmi i palestrës së sporteve “Jeton Terstena - TOTA”, që është ruajtur si material me vlerë, por që për shkak të vjetërsisë konsiderohet i panevojshëm për Komunën e Vushtrrisë. Materiali që do t'i nënshtrohet ankandit publik është si në vijim:**

**1.1 Kaldaja me pjesët përcjellëse, e cila ka qenë funksionale në Qendrën e kulturës;**

**1.2 51 radiatorë me dimensione të ndryshme;**

**1.3 39 trupa ndriçues, drita neoni në gjendjen si në foto;**

**1.4 gardhi metalik i shkallëve, i kombinuar me dru;**

**1.5 dyer dhe dritare që mund të vlerësohen të papërdorura;**

**1.6 sasi e materialit llamarinë e plastifikuar dhe një pjesë e zinkuar me dimension 1.15 x 14m për mbulimin e objekteve.**

**2. Autorizohet Kryetari i komunës që të themelojë komision profesional për caktimin e vlerës fillestare të materialit, ndërsa organi kompetent të zbatojë procedurat e shitjes përmes ankandit publik.**

**3. Në rast të mosparaqitjes së kërkesave për pjesëmarrje në ankand publik, Kryetarit të komunës i lejohet që ta dhurojë këtë material me vendim të tij.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria e Prokurimit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për anulimin e pjesshëm të vendimit të Kuvendit me Nr.362/18 i datës 27.12.2019.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim anulohet pjesërisht vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me Nr.362/18 i datës 27.12.2018, lidhur me caktimin e lokacionit për mbeturina inerte, në paragrafin i cili ka të bëjë me parcelën kadastrale me Nr.P-70202019-00131-0 Zona Kadastrale Gojbulë, e evidentuar si pronë e Ekonomisë së Pyjeve.
2. Pjesët tjera të këtij vendimi mbesin të pandryshuara dhe mund të prodhojnë efekt juridik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria e Prokurimit, si dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - pyeti se kur do të vjen propozimi për subvencionimin e nënave që lindin fëmijë, pasi ky premtim ka qenë edhe në fushatë elektorale.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - sqaroi se gjinekologjia nuk është pjesë e shëndetit primar, dhe vendimin që kanë marrë disa komuna që çdo nënë e cila lind në QKMF, të subvencionohet me 250 €, ato komuna do të kenë vështirësi në zbatimin e tyre. Sa i përket kësaj ai njoftoi se do bëhen hulumtime dhe konform kësaj dhe do të gjendet buxheti për një subvencionim të tillë të nënave.

Mbledhja përfundoi në ora 16:45.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

